



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr. 106, datë 5.10.2016

PËR

**MIRATIMIN E “SISTEMIT RAPORTUES PËR SHOQËRITË E KURSIM-KREDITIT DHE
UNIONET E TYRE”**

Në bazë dhe për zbatim të pikës 3 të nenit 43 të ligjit nr 52/2016, datë 19.05.2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre” dhe të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe të Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë Sistemin Raportues për Shoqëritë e kursim-kreditit dhe Unionet e tyre, sipas formularëve bashkëlidhur dhe të përcaktuar si më poshtë:
 - a) Raportimet nga Unionet për aktivitetin e tyre, sipas këtyre formularëve:
 - Formulari Nr.1: Aktivët
 - Formulari Nr.2: Pasivët
 - Formulari Nr.3: Llogaria fitim-humbje
 - Formulari Nr.4: Zërat jashtë bilancit
 - Formulari Nr.5: Kreditë e klasifikuara sipas kalimit të afatit të kthimit
 - Formulari Nr.6: Klasifikimi i kredive dhe llogaritja e provigjioneve
 - Formulari Nr. 6/1: Klasifikimi i linjave të kredisë për anëtarët
 - Formulari Nr.7: Cilësia e portofolit të kredisë
 - Formulari Nr.8: Depozitat sipas valutës dhe maturimit fillestar
 - Formulari Nr. 9: Pozicioni në valutë – Aktiv
 - Formulari Nr. 9/1: Pozicioni në valutë – Pasiv
 - Formulari Nr.10: Pozicionet e hapura valutore
 - Formulari Nr.11: Kapitali
 - Formulari Nr.12: Zërat e aktivitetit të ponderuar me rrezikun

- Formulari Nr.12/1: Zërat e aktivitet jashtë bilancit të ponderuar me rrezikun
- Formulari Nr.12/2: Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit
- Formulari Nr.13: Ekspozimet e mëdha
- Formulari Nr.14: Rreziku i likuiditetit
- Formulari Nr.14/1: Aktivitet sipas maturimit të mbetur
- Formulari Nr.14/2: Pasivet sipas maturimit të mbetur
- Formulari Nr.14/3: Kreditë me afat mbi 5 vjet
- Formulari Nr.14/4: Kreditë me afat mbi 10 vjet
- Formulari Nr.15: Tregues të tjerë
- Formulari Nr.16: Investimi i fondeve
- Formulari Nr.17: Evidenca e kreditit sipas afatit të maturimit
- Formulari Nr.18: Kredia sipas monedhës dhe maturimit
- Formulari Nr.19: Numri i degëve
- Formulari Nr.20: Numri i anëtarëve

b) Raportimet nga Unionet për totalin e shoqërive të kursim-kreditit, sipas këtyre formularëve:

- Formulari Nr.1: Aktivitet
- Formulari Nr.2: Pasivet
- Formulari Nr.3: Llogaria fitim-humbje
- Formulari Nr.4: Zërat jashtë bilancit
- Formulari Nr.5: Kreditë e klasifikuara sipas kalimit të afatit të kthimit
- Formulari Nr.6: Klasifikimi i kredive dhe llogaritja e provigjioneve
- Formulari Nr.6/1: Klasifikimi i qirasë financiare dhe llogaritja e provigjioneve
- Formulari Nr.7: Përqëndrimi i depozitave
- Formulari Nr.8: Depozitat e anëtarëve rezidentë sipas sektorit, afatit dhe monedhës
- Formulari Nr.9: Huatë e dhëna sipas aktivitetit ekonomik dhe cilësisë së portofolit
- Formulari Nr.10: Huatë e anëtarëve sipas sektorit, monedhës, afatit dhe qëllimit të përdorimit
- Formulari Nr.11: Kategoritë e kredive të dhëna nga totali i SHKK-ve
- Formulari Nr.12: Portofoli i qirasë financiare
- Formulari Nr.13: Bono thesari të emetuara nga qeveria shqiptare dhe të mbajtura nga SHKK-të
- Formulari Nr.14: Numri i SHKK-ve anëtare të Unionit
- Formulari Nr.15: Numri i anëtarëve të SHKK-ve
- Formulari Nr.16: Të dhëna mbi anëtarët

c) Raportimet nga Unionet me të dhëna individuale për çdo shoqëri kursim-krediti, ose nga vetë SHKK-ja në rastin kur nuk është anëtare e një Unioni, sipas këtyre formularëve:

- Formulari Nr.1: Aktivitet
- Formulari Nr.2: Pasivet
- Formulari Nr.3: Llogaria fitim-humbje

- Formulari Nr.4: Zërat jashtë bilancit
- Formulari Nr.5: Kreditë e klasifikuara sipas kalimit të afatit të kthimit
- Formulari Nr.6: Klasifikimi i kredive dhe llogaritja e provigjioneve
- Formulari Nr.6/1: Klasifikimi i qirasë financiare dhe llogaritja e provigjioneve
- Formulari Nr.7: Cilësia e portofolit të kredisë
- Formulari Nr.8: Përqëndrimi i depozitave
- Formulari Nr.8/1: Depozita të anëtarëve rezidentë sipas sektorit, afatit dhe monedhës
- Formulari Nr.9: Pozicioni në valutë - Aktivi
- Formulari Nr.9/1: Pozicioni në valutë - Pasivi
- Formulari Nr.10: Pozicionet e hapura valutore
- Formulari Nr.11: Kapitali
- Formulari Nr.12: Zërat e aktivitetit të ponderuar me rrezikun
- Formulari Nr.12/1: Zërat e aktivitetit jashtë bilancit të ponderuar me rrezikun
- Formulari Nr.12/2: Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit
- Formulari Nr.13: Ekspozimet e mëdha
- Formulari Nr.14: Rreziku i likuiditetit
- Formulari Nr.14/1: Aktivitet sipas maturimit të mbetur
- Formulari Nr.14/2: Pasivitet sipas maturimit të mbetur
- Formulari Nr.14/3: Kreditë me afat mbi 5 vjet
- Formulari Nr.14/4: Kreditë me afat mbi 10 vjet
- Formulari Nr.15: Tregues të tjerë
- Formulari Nr.16: Investimi i fondeve
- Formulari Nr.17: Huatë e dhëna sipas aktivitetit ekonomik dhe cilësisë së portofolit.
- Formulari Nr.18: Huatë e anëtarëve sipas sektorit, monedhës, afatit dhe qëllimit të përdorimit.
- Formulari Nr.19: Evidenca e kreditit sipas afatit të maturitetit
- Formulari Nr.20: Kredia sipas monedhës dhe maturimit
- Formulari Nr.21: Kategoritë e kredive të dhëna nga SHKK-ja
- Formulari Nr.22: Portofoli i qirasë financiare
- Formulari Nr.23: Evidenca e transfertave dhe pagesave
- Formulari Nr.24: Bono thesari të emetuara nga qeveria shqiptare dhe të mbajtura nga SHKK-të
- Formulari Nr.25: Numri i degëve
- Formulari Nr.26: Numri i anëtarëve
- Formulari Nr.27: Të dhëna mbi anëtarët

2. Raportimi i të dhënave sipas formularëve të mësipërm bëhet në periudha tremujore, siç përcaktohet në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe të Unioneve të tyre”.

3. Shënimet shpjeguese të formularëve janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Sistemi Raportues i Shoqërive të Kursim-Kreditit, miratuar me vendimin nr. 44, datë 08.06.2005, shfuqizohet.
5. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 30 qershor 2017.

SEKRETARI

KRYETARI

Elvis ÇIBUKU

Gent SEJKO